



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit / Ured Premijera / Office of the prime Minister
Agjencia për Barazi Gjinore / Agencija za Ravnopravnost Polova / Agency of Gender Equality

Përkufizimet dhe konceptet gjinore

Prishtinë, Tetor 2012
Ribotim



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit / Ured Premijera / Office of the prime Minister
Agjencia për Barazi Gjinore / Agencija za Ravnopravnost Polova / Agency of Gender Equality

Përkufizimet dhe konceptet gjinore

Prishtinë, tetor 2012,
Ribotim





Përmbajtja:

Përkatësia Gjinore (Gender).....	5
Seksi	6
Termi “Marrëdhënie Gjinore”	6
Ndarja gjinore e punës	6
Puna Prodhuese	7
Puna Riprodhuese	7
Puna Komunitare	7
Aksesi (qasja).....	8
Kontrolli	8
Kushtet e grave	10
Pozita e Grave.....	10
Diskriminimi	11
Fuqizimi	11
Gratë në Zhvillim(WID)	12
Përkatësia gjinore dhe zhvillimi(GAD)	12
Integrimi gjinor	12
Barazia gjinore(equality)	13
Drejtësia gjinore(equity)	13
Barazia gjinore përkundër drejtësisë gjinore	14
Barazia gjinore si objektiv zhvillimi	15
Barazia dhe zhvillimi i qëndrueshëm	16
Feminizmi	16
Nevojat gjinore	16
Nevojat gjinore praktike	17
Buxhetimi gjinor.....	17



Përkatësia Gjinore (Gender)

I referohet mundësive dhe attributeve sociale të lidhura me faktin e të qenit burrë apo grua, vajzë apo djalë, po ashtu edhe marrëdhënieve mes grave dhe burrave.

Këto attribute, mundësi dhe marrëdhënie janë të ndërtuara dhe mësohen nga shoqëria gjatë procesit të socializmit.

Ato janë të orientuara nga koha dhe janë të ndryshueshme.

Përkatësia gjinore (gender) përcakton se çfarë pritet, lejohet dhe vlerësohet tek një grua apo tek një burrë në një kontest të dhënë. Në shumicën e shoqërive ka diferenca dhe pabarazi midis grave dhe burrave për sa i përket përgjegjësive që u caktohen, aksesit ndaj dhe mbi burimet, si dhe mundësive për të marrë vendime. 'Gender' është pjesë e një kontesti socio-kulturor më të gjerë. Kriteret tjera të rëndësishme për analizimin e kontestit socio-kulturor janë klasa, raca, niveli i varfërisë, grupi etnik, mosha etj.



Seksi

I referohet dallimeve biologjike midis burrave dhe grave, të cilat janë universale dhe nuk ndryshojnë. Seksi është natyral. Ai i referohet ndryshimeve të mundshme në organet gjenitale dhe ndryshimet e lidhura me to në funksionet riprodhuese .

Termi “Marrëdhënie Gjinore”

I referohet marrëdhënieve të pushtetit mes burrave dhe grave, të cilat shfaqen në një sërë praktikash, idesh, manifestimesh, përfshirë këtu ndarjen e punës, rolet dhe burimet mes burrave dhe grave dhe caktimi i aftësive, qëndrimeve, dëshirave, tipareve të personalitetit, modeleve të sjelljes së ndryshme, etj, burrave dhe grave. Marrëdhëniet gjinore janë të formuara si dhe ndihmojnë në formimin e këtyre praktikave dhe ideologjive në ndërveprim me struktura të tjera të hierarkisë shoqërore si kasta, klasa dhe raca. Këto mund të shihen si të ndërtuara gjerësisht nga shoqëria (sasa nga biologjia) dhe si të ndryshueshme në kohë dhe hapësirë.

Ndarja gjinore e punës

Ka të bëjë me caktimin e roleve, përgjegjësive dhe detyrave të ndryshme të burrave dhe grave, bazuar në idetë shoqërore të asaj që burrat dhe gratë duhet të bëjnë dhe janë të aftë të bëjnë. Detyra dhe përgjegjësi të ndryshme iu caktohen vajzave dhe djemve, grave dhe burrave, sipas roleve të tyre dhe jo domosdoshmërisht sipas aftësive ose preferencave të tyre personale.



Puna Prodhuese

Ka të bëjë me punën që kryhet për të prodhuar mallra e shërbime në shkëmbim të të ardhurave. Edhe burrat edhe gratë kontribuojnë në të ardhurat e familjes me forma të ndryshme të punës prodhuese, ndonëse burrat mbizotërojnë në punën prodhuese, sidomos në shkallët më të larta të shpërblimit.

Puna riprodhuese

Përfshin – riprodhimin biologjik dhe social. Riprodhimi biologjik i referohet lindjes së qenieve të reja njerëzore , një aktivitet të cilin vetëm gratë mund ta kryejnë. Riprodhimi social i referohet gjithë aktiviteteve të përkujdesjes të nevojshme për të siguruar mbijetesën dhe vazhdimësinë njerëzore. Kujdesi për fëmijët, gatimi, ushqimi, larja, pastrimi, ushqimi me gji dhe aktivitete tjera shtëpiake futen në këtë kategori.

Megjithëse ato janë të nevojshme për mbijetesën njerëzore, nuk konsiderohen as punë, as aktivitet ekonomik, dhe si të tilla janë të padukshme, të panjohura dhe të papaguara. Puna riprodhuese kryhet kryesisht nga gratë dhe vajzat.

Puna Komunitare

I referohet të gjitha atyre aktiviteteve te nevojshme për të menaxhuar dhe organizuar jetën komunitare.

Qeverisja, organizimi dhe pjesëmarrja në festivale kulturore dhe shoqërore, shërbimet shoqërore dhe shërbimet e tilla si rrugët, shkollat,shërbimi shëndetësor etj, Janë të gjitha aktivitete komunitare. Si burrat ashtu dhe gratë marrin pjesë në to, por përsëri sipas normave të cekura, që përcaktojnë aktivitetet “mashkullore” dhe “femërore”.



Aksesi (qasja)

Nënkupton mundësitë e grave dhe burrave për të siguruar apo përdorur burimet (ushqime, kredi, teknologji etj) ose shërbimet (arsim, shërbim shëndetësor, etj). Mundësia për të përfituar mbi burimet nuk nënkupton patjetër se njerëzit do të kenë pushtet për të vendosur apo për të kontrolluar mirat që rrjedhin prej aktiviteteve të tilla. Është e rëndësishme të dallohet ndryshimi mes “përdorimi i” dhe “kontroll mbi” një burim të caktuar. Për shembull, gratë në zonat rurale shpesh kanë qasja mbi tokën apo kredinë, por ato nuk kanë pushtet apo mundësi për të marrë vendime mbi këto burime.

Kontrolli

I referohet kapacitetit për të marrë vendime mbi një burim apo situatë të caktuar. Është e rëndësishme të dallohet ndryshimi mes aksesit (qasjes në) dhe kontrollit mbi përfitimet që rrjedhin nga përdorimi i burimeve nga ana tjetër. Edhe në rast se gratë kanë burime të pafundme, ato shpesh nuk kanë mundësi të përfitojnë nga përdorimi i tyre. Të dhënat bazë në një analizë të plotë gjinore përcaktojnë nëse ka ndonjë ndryshim në aksesin dhe kontrollin e burrave dhe grave ndajë tri kategorish kyçe të burimeve.



Burimet Ekonomike\ Prodhuese:
Toka, kredia, të ardhurat në para, punësimi

Burimet Politike

Arsim, përfaqësim politik, udhëheqje

Koha:

Një burim kritik, i cili përfiton gjithnjë e më shumë vlerë
monetare

Është e qartë pra që të kesh akses (qasje) apo të kesh kontroll mbi një burim, nuk është e njëjta gjë. Një shembull i thjeshtë të ndryshimit është:

Një grua që në fillim të çdo muaji e dorëzon pagën e saj tek i shoqi, apo është shtëpiake mund të ketë qasje në të ardhurat familjare, për shembull për ti bërë blerjet e nevojshme (ushqime, detergjente etj), por ajo domosdoshmërisht ka dhe kontrollin e këtyre të ardhurave, si në rastin kur për çdo blerje tjetër ajo duhet t'i marrë leje të shoqit (për shembull për të blerë diçka për veten e saj).

Nëse gratë kanë vetën qasje mbi burimet por u mungon kontrolli atëherë ato nuk mund të përcaktojnë prioritetet për përdorimin e burimit, pra për çfarë do ta përdorin (për shembull, për çfarë do të përdoren të ardhurat mujore të familjes), si rrjedhim edhe qasja i tyre ndaj përfitimeve, të cilat kategorizohen si më poshtë, do të jetë i kufizuar (për shembull, gruaja nuk mund t'i përdorë ato para për t'u regjistruar në një kurs):



Përfitimet:

1. Sigurimi i nevojave bazë
2. Sigurimi i parave dhe të ardhurave
3. Asetet dhe prona
4. Edukim, Trajnim
5. Fuqi, pushtet politik, prestigj, status
6. Mundësi për të nxitur interesa të tjera.

Meqenëse gratë zakonisht punojnë më gjatë se burrat, ata kanë më pak qasje se burrat, ndaj një prej burimeve më të rëndësishme: kohës. Kjo si rrjedhim kufizon qasjen e grave ndaj burimeve dhe përfitimeve sociale si shkollat dhe trajnimet, të cilat mund të hapin mundësi të reja jetese dhe të ardhurash. Kjo prek veçanërisht pjesëmarrjen e gruas në nivelet vendimmarrëse.

Pozita e Grave

Është vendosja apo statusi i tyre në shoqëri në lidhje me burrat. Për të vlerësuar pozitën, nevojitet të shohim marrëdhëniet shoqërore të gjinisë apo marrëdhëniet e pushtetit mes grave dhe burrave.

Kushtet e grave

Janë gjendja e tyre materiale nga pikëpamja e nivelit të ushqimit, shëndetit, qasjes ndaj nevojave bazë, arsimit, dhe këto mund të përmirësohen duke ofruar ushqimin, shërbimet shëndetësore, arsim etj.



Diskriminimi

Është një sjellje e dukshme me anë të së cilës njerëzit` trajtohen ndryshe dhe jo në mënyrë të favorshme, në bazë të racës, klasës,seksit apo statusit kulturor të tyre.

Diskriminimi pakëson mundësitë për të pasur qasje mbi burimet,shërbimet shëndetësore, arsimimin, fuqizimin apo pushtetin. Në terminologjinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), konsiderohet si përjashtim,pengesë apo dallim i bërë në bazë të seksit,që ka si qëllim apo efekt,mohimin e ushtrimit të barabartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të gjitha fushat e përpjekjeve njerëzore.

Fuqizimi

Është proces, përmes të cilit burrat dhe gratë që ndodhen në pozita të pa favorshme,rritin qasjen e tyre ndaj informacionit,burimeve e pushtetit vendim-marrës si dhe ndërgjegjësimin e tyre lidhur me pjesëmarrjen në jetën komunitare,me qëllim që të arrijnë një nivel të caktuar kontrolli mbi mjedisin ku jetojnë.

***Shembull:** Në Indi, një lëvizje e madhe me qëllim fuqizimin e gruas dhe si një masë kundër varfërisë, Amendamentet 73 dhe 74 të Kushtetutës(Panchayat Raj Act) të vitit 1993 siguruan një minimum prej 1/3 e vendeve për gratë në të gjitha postet shtetërore, përkatësisht 250,000 gra të punësuar në nivel lokal.*



Gratë në Zhvillim(WID)

WID u bë e njohur në fillimin e viteve 1970-të si një përfaqëse për përfshirjen e grave në zhvillim. Kërkimet dhe informacioni i grumbulluar gjatë Dhjetëvjeçarit të OKB-së për Gratë (1975-85) evidentoi varfërinë dhe disavantazhin ekzistues të grave dhe padukshmërinë e tyre në procesin e zhvillimit. Përgjigjet e ndërhyrjet e ndryshme të politikave u fokusuan mbi gratë si një grup i veçantë dhe rezultuan në shndërrimin e shqetësimeve të grave në 'shtesë' dhe periferike ndaj përpjekjeve qendrore për zhvillim. Politikat dhe ndërhyrjet WID janë përqendruar kryesisht mbi punën prodhuese të grave.

Përkatësia gjinore dhe zhvillimi (GAD)

Strategjia "Përkatësia gjinore dhe zhvillimi" lindi nga analiza e marrëdhënieve shoqërore mes grave dhe burrave për të shpjeguar pse gratë ishin akoma të marginalizuara në procesin e zhvillimit, megjithëse kontributi specifik i tyre kishte filluar të njihet me qëndrimin "gruaja në zhvillim". Përkatësia gjinore e zhvillimit. "Përkatësia gjinore e zhvillimit" trajton lidhjen mes marrëdhënieve gjinore dhe mundësive të pabarabarta në burimet natyrore, sociale dhe ekonomike. Ky qëndrim nuk i konsideron gratë, rolet, nevojat dhe aspiratat e tyre në izolim nga ato të burrave.

Integrimi gjinor

Është (ri)organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve politike, në mënyrë që perspektiva e barazisë gjinore të përfshihet në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, nga aktorët që përfshihen në hartimin e politikave.



Është një strategji për t'i ngritur shqetësimet e grave dhe të burrave dhe eksperiencat e tyre në një dimension integral në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve në sferën politike, ekonomike, sociale etj.

Barazia gjinore (equality)

Ky është një parim, sipas të cilit të gjitha qeniet njerëzore, pa dallim race, seksi, bindjeje fetare, niveli social-kulturor apo status politik, duhet të kenë të drejta ligjore të barabarta.

Në kontestin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, koncepti ligjor i barazisë gjinore është sanksionuar si në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948 ashtu edhe në Konventën e Kombeve të bashkuara mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) të vitit 1979. Konventa, e cila është ratifikuar nga 100 vende, deklaron qarte dhe pa ekuivok që "diskriminimi kundër grave dhunon parimet e barazisë së të drejtave dhe respektit për dinjitetin njerëzor" Qeveritë e botës riafirmuan angazhimin e tyre në vitin 1995 për "te drejtat e barabarta dhe dinjitetin e lindur njerëzor të të gjitha grave dhe burrave" në Deklaratën e Platformën e Pekinit për Veprim.

Drejtësia gjinore (equity)

Drejtësia gjinore merret me promovimin e barazisë personale, shoqërore, kulturore, politike dhe ekonomike për të gjithë. Termi drejtësi gjinore lindi nga të kuptuarit gjithnjë e me shumë të padrejtësive të kudo gjetura në shoqëri, traditat në vazhdimësi të koncepteve steropite dhe praktikave diskriminuese kanë rezultuar me



zhvlerësimin sistematik të qëndrimeve, veprimtarive dhe aftësive që i atribuohen vajzave dhe grave. Pasojat negative të koncepteve stereotipe dhe praktikave diskriminuese ndikojnë pafavorshëm si meshkujt ashtu edhe femrat. Megjithatë, nga pikëpamja afatshkurtër, theks më i madh në nismat për drejtësinë gjinore do të vendoset mbi përmirësimin e kushteve dhe qëndrimeve që prekin vajzat dhe gratë. Nga pikëpamja afatgjatë, këto nisma do të përmirësojnë gjithashtu edhe situatën për djemtë e burrat.

Barazia gjinore përkundrejt drejtësisë gjinore

Edhe pse termat barazi dhe drejtësi gjinore janë përdorur shpesh në vend të njëri-tjetrit, ata tashmë kanë kuptime specifike dhe të ndryshme dhe nuk duhet ngatërruar.

Barazia gjinore i referohet trajtimit të njëjtë apo uniformitetit në sasinë, vlerën dhe intensitetin e masave të marra dhe të zbatuara për burrat dhe gratë. Barazia gjinore mund të shprehet përmes legjislacionit, ndërkohë drejtësia gjinore nënkupton që të bëhet çfarë është e nevojshme për të siguruar barazi rezultatesh në eksperiencat e jetës të burrave dhe të grave. Drejtësia gjinore është e vështirë të shprehet përmes legjislacionit: trajtimi identik mundë të kënaq kriterin e barazisë, por jo atë të drejtësisë.

Barazia e rezultatit, që ndryshe quhet 'barazia thelbësore' potencon idenë që barazia në shanse mund të mos jetë e mjaftueshme për të riparuar shtypjen dhe disavantazhin historik të grave.



Për shkak të pozicioneve të ndryshme në shoqëri, gratë e burrat mund të mos jenë të aftë të shfrytëzojnë shanse të barabarta në të njëjtën masë. Në disa raste, shanset e barabarta mund të kenë në fakt një ndikim negativ mbi mirëqenien e grave nëse gratë ushtrojnë kohë dhe energji për të shfrytëzuar ato pa ndonjë rezultat.

Me qëllim që të sigurohet që ndërhyrjet e zhvillimit të rezultojnë në barazi të rezultatit për gratë dhe burrat, është e nevojshme që ato të ndërtohen mbi bazën e analizës gjinore. Për pasojë, trajtim 'i barabartë' nuk do të thotë trajtim 'i njëjtë'!

Barazia gjinore si objektiv zhvillimi

'Në Konferencën e katërt Botërore të Kombeve të Bashkuara për Gratë mbajtur në Pekin 1995, si anëtarët e DAC ashtu edhe vendet partnere të tyre morën angazhime për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Deklarata e Pekinit e adoptuar në Konferencë ndërtohet mbi perspektivat dhe strategjitë e përvijuara në konferencat e mëparshme të Kombeve të Bashkuara mbi arsimin - Jomtien, (1990), mjedisin-Rio(1992), të drejtat e njeriut- Vjenë (1993), popullsinë- Kairo(1994), dhe zhvillimin shoqëror-Kopenhage (1995), përfshi edhe konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW 1979). Ajo bazohet mbi parimet e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë shoqërore. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave janë të domosdoshme për trajtimin e problemit të varfërisë dhe pasigurisë, si dhe për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, me njerëzit në qendër.



Barazia dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Që të ndodhë zhvillimi i plotë njerëzor kërkohen dy lloje barazie-barazia për brezat e njerëzimit që do të vijnë, interesat e të cilëve nuk përfaqësohen nga analiza ekonomike standarde apo forca tregu që zbresin të ardhmen dhe barazi për njerëzit që jetojnë tani, të cilët nuk kanë akses të barabartë ndaj burimeve natyrore apo ndaj' të mirave' shoqërore dhe ekonomike. Në fakt, ka njëfarë konflikti midis këtyre dy llojeve të barazisë. Disa komentues vënë në dukje që çështjet mjedisore në vendet në zhvillim nuk mund të zgjidhen pa zbutur varfërinë dhe bëjnë thirrje për rishpërndarje të pasurisë apo të ardhurave si brenda vendeve, ashtu edhe midis vendeve të pasura dhe të varfra.

Feminizmi

Është një lëvizje mbarë botërore që kërkon të rrisë statusin politik, ekonomik dhe social të grave,dhe që lufton për barazinë gjinore në të gjitha aspektet e jetës në të gjitha shoqëritë. Koncepti themelor i feminizmit vazhdon të përfshihet në përshtatje me kontestin socio-ekonomik,politik dhe kulturor, në të cilin po ndodh lëvizja edhe nevoja të ndryshme. Është mjaft e nevojshme dhe e rëndësishme të dallojmë dy lloje nevojash; nevojat gjinore praktike dhe interesat gjinorë strategjik.



Nevojat gjinore praktike

Janë nevojat që gratë dhe burrat mund t'i identifikojnë lehtë, meqenëse lidhen me jetën e përditshme. Gratë mund të identifikojnë nevojën për ujë të pijshëm, ushqimin, mjedisin shëndetësor, të ardhurat në para, si nevoja imediate që ato duhet t'i përmbushin. Plotësimi i nevojave gjinore praktike të grave është me rëndësi qendrore për të përmirësuar kushtet e jetesës, por në vetvete nuk ndryshon pozitën mbizotëruese në disavantazh (të dytësuar) të grave.

Nevojat gjinore

Dallojnë nga nevojat në përgjithësi për shkak se ato dalin nga rolet gjinore, ndarja gjinore e punës dhe nga ndërlikimet e vazhdueshme që vijnë prej mungesës së aksesit (qasjes) ndaj burimeve dhe nga marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit. Për shkak se kanë role të ndryshme në shoqëri, gratë dhe burrat kanë.

Buxhetimi gjinor

Buxhetimi gjinor është proces nëpërmes të cilit analizohen buxhetet publike, duke i vlerësuar sa i përgjigjen ato nevojave të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave, si dhe nëse ato kontribuojnë apo jo për rritjen e barazisë midis grave dhe burrave. Buxhetimi i ndjeshëm gjinor i paraprinë ndërmarrjes së iniciativave për arritjen e barazisë gjinore .



Dizajni dhe Printimi
www.europrinty.net

